

Mazars Sh.p.k.

Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

PËRMBAJTJA:

	FAQE
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCËS	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 - 21

Mazars sh.p.k.
Pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e Pozicionit Financiar
 më 31 dhjetor 2017**

	Shënime	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	58,839,016	45,735,067
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	24,746,144	26,372,629
Të tjera llogari të arkëtueshme	6	808,801	1,380,868
Shpenzime të shtyra	7	9,636,646	9,299,810
Total aktive afatshkurtra		94,030,607	82,788,374
Aktivët afatgjatë			
Aktive afatgjatë materiale	8	8,253,233	5,449,946
Aktive afatgjatë jomateriale	9	114,866	206,306
Total aktive afatgjatë		8,368,099	5,656,252
Total aktive		102,398,706	88,444,626
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	10	382,955	1,224,653
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	11	3,134,162	1,467,824
Detyrime tatimore	12	13,106,860	12,065,230
Të ardhurat e shtyra	13	454,033	129,020
Të tjera detyrime	14	36,717,430	31,834,617
Total detyrime afatshkurtra		53,795,440	46,721,344
Detyrime afatgjatë			
Llogari të pagueshme nga palët e lidhura	15	22,276,321	28,493,793
Të tjera detyrime	16	2,060,725	2,096,065
Total detyrime afatgjatë		24,337,046	30,589,858
Totali i detyrimeve		78,132,486	77,311,202
KAPITALI			
Kapitali i nënshkruar	17	100,000	100,000
Rezerva nga perkthimi		34,868	-
Rezerva ligjore		10,000	10,000
Rezerva të tjera		11,023,425	4,931,443
Fitimi i ushtrimit		13,097,927	6,091,981
Total kapitali		24,266,220	11,133,424
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		102,398,706	88,444,626

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Mazars sh.p.k.
Pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Performancës
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	18	149,108,227	121,353,113
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	19	(378,256)	(196,839)
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme		(28,084,883)	(20,554,815)
1) Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	20	(15,159,563)	(11,360,750)
2) Të tjera shpenzime	21	(12,925,320)	(9,194,065)
Shpenzime të personelit	22	(104,380,277)	(88,612,096)
1) Paga dhe shpërblime		(99,962,871)	(84,710,149)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore		(4,417,406)	(3,901,947)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	8/9	(1,910,417)	(1,360,015)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	23	989,700	(3,000,000)
Të ardhura të tjera		-	-
Shpenzime financiare	24	186,207	332,285
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme		(9,777)	(1,766)
2) Shpenzime të tjera financiare		195,984	334,051
Fitimi/humbja para tatimit		15,530,301	7,961,633
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	25	(2,432,374)	(1,869,652)
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(2,432,374)	(1,869,652)
Fitimi/humbja e vitit		13,097,927	6,091,981
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin:		34,868	-
Diferencat (+/-) nga përkthimi i monedhës në veprimtari të huaja		34,868	
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		13,132,795	6,091,981

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Mazars sh.p.k.

Pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva nga përkthimi	Rezerva Ligjore	Rezerva të tjera	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2015	100,000	-	10,000	328,843	4,602,600	5,041,443
Fitimi / Humbja e vitit					6,091,981	6,091,981
Lëvizjet përmes kapitalit				4,602,600	(4,602,600)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2016	100,000	-	10,000	4,931,443	6,091,981	11,133,424
Fitimi / Humbja e vitit					13,097,928	13,097,928
Lëvizjet përmes kapitalit				6,091,981	(6,091,981)	-
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		34,868				34,868
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2017	100,000	34,868	10,000	11,023,424	13,097,928	24,266,220

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 janë aprovuar nga administratori i Mazars sh.p.k më 30 mars 2018 dhe janë firmosur si më poshtë.

Teit Gjini
Administrator

Bernard Çumashi
Hartuesi i Pasqyrave Financiare

M MAZARS

Rr. Emin Duraku, Pall. "Binjaket",
No.5, 1000, Tirana, Albania
phone: +355 42 27 80 15
www.mazars.al, info@mazars.al

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	13,097,927	6,091,981
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare	486,208	66,356
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	546,780	202,166
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	1,910,417	1,360,015
Diferenca nga përkthimi asetëve	(2,761)	
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	1,861,716	(2,231,999)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	2,337,730	2,342,237
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	4,189,586	14,094,294
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	24,427,603	21,925,050
Fluksi i mjeteve monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(4,619,502)	(963,309)
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata jo materiale	-	(15,525)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(4,619,502)	(978,834)
Fluksi i mjeteve monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Pagesa e huave	(6,056,828)	(15,620,646)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	(6,056,828)	(15,620,646)
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	13,751,273	5,325,570
Diferenca nga përkthimi	34,868	
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	45,735,067	40,809,903
<i>Efekt i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare</i>	(682,192)	(400,406)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	4 58,839,016	45,735,067

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "Mazars" sh.p.k (ish-Gjini Consulting sh.p.k) është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më 13 qershor 2000 në përputhje me Ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Mbi Shoqëritë Tregtare".

Shoqëria "Gjini Consulting" sh.p.k u bë anëtar plotësisht i integruar në partnershipin Global të MAZARS që prej datës 1 janar 2015, dhe që prej kësaj date emri i saj është "Mazars" sh.p.k.

Shoqëria është regjistruar pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore me NIPT K32123006W.

Selia e shoqërisë është në Rr."Emin Duraku", Pall. "Binjaket", Nr 5, Kati i I-rë teknik, Ap. 1 dhe 2, Tiranë.

Kapitali i shoqërisë përbëhet nga 100 kuota me vlerë nominale 100,000 LEK i ndarë në 100 kuota me vlerë nominale 1,000 LEK.

Mazars Sh.p.k është një shoqëri shqiptare, e zotëruar nga ortakët:

- Z. Teit Gjini, zotëruar i 50 kuotave ose 50% të kapitalit të shoqërisë;
- Zj. Irena Pulo, zotëruar e 5 kuotave ose 5% të kapitalit të shoqërisë;
- Zj. Diana Ylli, zotëruar e 45 kuotave ose 45% të kapitalit të shoqërisë.

Administrator i shoqërisë është Z. Teit Gjini

Aktiviteti kryesor i shoqërisë është kryerja e shërbimeve të auditimit dhe e shërbimeve të tjera të dhënies së sigurisë, të shërbimeve të lidhura, sipas përcaktimit të këtyre shërbimeve të dhëna nga IFAC. Kryerja e shërbimeve të mbajtjes së kontabilitetit, deklarimeve tatimore, hartimi i pasqyrave financiare etj.

Më 31 dhjetor 2017 Shoqëria kishte 33 punonjës (2016: 29 punonjës).

Shoqëria "Mazars" sh.p.k, më 1 janar 2017, ka hapur degën e saj në Kosovë me NIPT 601719787. Selia e shoqërisë Mazars – Dega në Kosovë është në Rr. Pashko Vasa, nr. 45/6, Prishtinë.

Administrator i shoqërisë është Zj. Violeta Haxhillazi

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe amenduar me urdhrin nr.64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuar dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre duke filluar nga 1 janar 2015. Ky urdhër hyri në fuqi në fletoren zyrtare nr.119 datë 1 gusht 2014.

Kompania përdor formatin e publikuar nga SNK për prezantimin e pasqyrave financiare.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.1. Transaksionet në monedhë të huaj (vazhdim)**

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2017	2016
Eur/LEK	132.95	135.23
USD/ LEK	111.10	128.17
CHF/LEK	113.94	126.05

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dheshpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.4. Aktive afatgjata material (vazhdim)***ii. Kostot e mëpasshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2017 dhe 2016 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mobilje për zyrën dhe kantierin	Vlera e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25 %
Të tjera	Vlera e mbetur	20 %
Aktive Afatgjata jomateriale	Lineare	15%

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë. Shoqëria i njeh të ardhurat kur transmeton energjinë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.7. Qiratë (vazhdim)

ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka vetëm qira operative.

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2017 është 15% (2016: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundur që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

Shoqëria nuk ka njohur tatim të shtyrë për humbjet e mbartura fiskale.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.12. Provizionet**

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerre

3.13. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Mjete monetare në bankë	54,378,726	45,384,411
Llogari rrjedhëse	54,378,726	45,384,411
Mjete monetare në arkë	53,132	350,656
Nën Totali	54,431,858	45,735,067
Mjete monetare Dega Kosovë	4,407,158	
Totali	58,839,016	45,735,067

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogari të arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Klientë	29,792,348	34,372,629
Zhvlerësim i llogarive të arkëtueshme	(7,000,000)	(8,000,000)
Nën Totali	22,792,348	26,372,629
Klientë dega në Kosovë	1,953,796	
Totali	24,746,144	26,372,629

5. Llogari të arkëtueshme tregtare (vazhdim)

Lëvizjet në zhvlerësimin e të drejtave për arkëtim për vitin 2017 dhe 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Gjendja në fillim të vitit	(8,000,000)	(5,000,000)
Provizionuar gjatë vitit ushtrimor		(3,000,000)
Rimarrje gjatë vitit ushtrimor	1,000,000	
Totali	<u>(7,000,000)</u>	<u>(8,000,000)</u>

6. Të tjera llogari të arkëtueshme

Të tjera llogari të arkëtueshme më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Fond garanci për zyrat	-	766,303
Detyrime doganore	2,414	3,012
Përfitime afatshkurta nga sigurimet	114,439	208,420
TVSH	112,625	-
Të tjera	579,323	403,133
Totali	<u>808,801</u>	<u>1,380,868</u>

7. Shpenzime të shtyra

Shpenzime të shtyra më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Shpenzime të periudhave të ardhme për përshtatje ambiente pune	9,636,646	9,299,810
Totali	<u>9,636,646</u>	<u>9,299,810</u>

8. Aktive afatgjata materiale

	AQT Kosova	Mobilje orendi	Pajisje kompjuterike	Të tjera	Totali
Kosto					
Gjendja më 31 dhjetor 2015		4,789,623	2,522,299	1,777,361	9,089,283
Shtesa		102,382	841,838	19,089	963,309
Nxjerrje jashtë përdorimit					-
Gjendja më 31 dhjetor 2016	-	4,892,005	3,364,137	1,796,450	10,052,592
Shtesa	1,528,465		1,930,843	1,160,195	4,619,503
Nxjerrje jashtë përdorimit					-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	1,528,465	4,892,005	5,294,980	2,956,645	14,672,095
Zhvlërësimi i akumuluar					
Gjendja më 31 dhjetor 2015		(1,842,558)	(824,759)	(666,172)	(3,333,489)
Amortizimi i vitit		(626,330)	(420,407)	(222,420)	(1,269,157)
Nxjerrje jashtë përdorimit					-
Gjendja më 31 dhjetor 2016	-	(2,468,888)	(1,245,166)	(888,592)	(4,602,646)
Amortizimi i vitit	(308,453)	(519,830)	(640,444)	(350,250)	(1,818,977)
Diferenca nga perkthimi	2,761				2,761
Nxjerrje jashtë përdorimit					-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	(305,692)	(2,988,718)	(1,885,610)	(1,238,842)	(6,418,862)
Gjendja më 31 dhjetor 2015	-	2,947,065	1,697,540	1,111,189	5,755,794
Gjendja më 31 dhjetor 2016	-	2,423,117	2,118,971	907,858	5,449,946
Gjendja më 31 dhjetor 2017	1,222,773	1,903,287	3,409,370	1,717,803	8,253,233

9. Aktive afatgjata jomateriale

	Programe	Totali
Kosto		
Gjendja më 31 dhjetor 2015	594,073	594,073
Shtesa	15,525	15,525
Nxjerrje jashtë përdorimit		
Gjëndja më 31 dhjetor 2016	609,598	609,598
Shtesa		-
Nxjerrje jashtë përdorimit		-
Gjëndja më 31 dhjetor 2017	609,598	609,598
Zhvlerësimi i akumuluar		
Gjendja më 31 dhjetor 2015	312,434	312,434
Amortizimi i vitit	90,858	90,858
Nxjerrje jashtë përdorimit		
Gjëndja më 31 dhjetor 2016	403,292	403,292
Amortizimi i vitit	91,440	91,440
Nxjerrje jashtë përdorimit		-
Gjëndja më 31 dhjetor 2017	494,732	494,732
Gjendja më 31 dhjetor 2015	281,639	281,639
Gjendja më 31 dhjetor 2016	206,306	206,306
Gjendja më 31 dhjetor 2017	114,866	114,866

10. Llogari të pagueshme tregtare

Llogari të pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Furnitorë vendas	326,894	1,171,335
Furnitorë për fatura të pa mbërritura	34,177	53,318
Nën Totali	361,071	1,224,653
Furnitorë Dega në Kosovë	21,884	
Totali	382,955	1,224,653

11. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Llogari të pagueshme tregtare	3,043,856	1,467,824
Nën Totali	3,043,856	1,467,824
Llogari të pagueshme tregtare Dega Kosovë	90,306	
Totali	3,134,162	1,467,824

12. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Kontribute për Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore	642,458	613,559
Tatimi mbi të Ardhurat nga Punësimi	11,760,694	9,486,575
Tatim në Burim	39,863	183,732
Tatim Fitimi	546,780	202,166
TVSH për t'u paguar	-	1,579,198
Nën Totali	12,989,795	12,065,230
Të tjera detyrime Dega Kosovë	117,065	
Totali	13,106,860	12,065,230

13. Të ardhurat e shtyra

Të ardhurat e shtyra për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Parapagim nga klientë	454,033	129,020
Totali	454,033	129,020

14. Të tjera detyrime

Të tjera detyrime paraqesin detyrimet ndaj punonjësve dhe detyrime të tjera dhe më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Detyrime ndaj personelit	35,651,000	31,461,414
Debitorë dhe kreditorë të tjerë	394,609	373,203
Nën Totali	36,045,609	31,834,617
Të tjera detyrime Dega Kosovë	671,821	-
Totali	36,717,430	31,834,617

15. Llogari të pagueshme nga palët e lidhura

Llogaritë të pagueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Finacim nga Ortaket	22,276,321	28,493,793
Totali	22,276,321	28,493,793

16. Të tjera detyrime

Të tjera detyrime për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Hua	2,060,725	2,096,065
Totali	2,060,725	2,096,065

17. Kapitali

Kapitali i shoqërisë është 100,000 LEK i zotëruar si më poshtë përkatësisht për vitet 2017 dhe 2016:

Aksioneri	Kuotat	31 dhjetor 2017			31 dhjetor 2016			
		Vlera nominale	Vlera nominale	%	Kuotat	Vlera nominale	Vlera nominale	%
Teit Gjini	50	1,000	50,000	50%	50	1,000	50,000	50%
Irena Puno	5	1,000	5,000	5%	5	1,000	5,000	5%
Diana Ylli	45	1,000	45,000	45%	45	1,000	45,000	45%
Totali	100		100,000	100%	100		100,000	100%

18. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga shërbimet, Tiranë	144,962,455	121,353,113
Nën Totali	144,962,455	121,353,113
Të ardhura Dega Kosovë	4,145,772	
Totali	149,108,227	121,353,113

Rakordimi i të ardhurave me deklaratimet në IEKA

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Të ardhura nga aktiviteti kryesor	144,962,455	
Të ardhura nga përkthimet (perfshirë në notën 19)	163,480	
Totali	145,125,935	

18. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit (vazhdim)

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së.

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Rakordimi i të ardhurave me FDP-në	
Shitje total të deklaruara në FDP TVSH	145,919,952
Parapagime	(327,075)
Diferencë kursi nga parapagimet	1,274
Shitje të deklaruara në FDP që janë të ardhura në PASH	145,594,151
Shërbime	149,108,227
Të tjera	631,678
Të ardhura të deklaruara në PASH të cilat janë deklaruar shitje në FDP	149,739,905
Fitime nga gabime të lejuara në ushtrimet paraardhëse	
Të ardhurat nga interesat	413
Fitim nga këmbimet valutore	781,887
Total të ardhura të deklaruara FDP e Tatim Fitimit	150,522,205

19. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Fitime nga këmbimet valutore	460,443	442,346
Humbje nga këmbimet valutore	(1,465,631)	(1,009,141)
Të ardhura nga të tretët për vënien e ambjenteve në dispozicion	180,000	180,000
Të ardhura nga përkthime	163,480	109,556
Të ardhura të tjera	283,452	80,400
Totali	(378,256)	(196,839)

20. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndeve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen më veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Nënkotraktorë	4,781,777	3,029,548
Qira zyra	3,219,200	3,296,520
Honorare dhe shërbime teknike	3,172,216	2,226,083
Shpenzime për përshtatje zyra	1,284,870	1,178,070
Shpenzime materiale konsumi	731,037	960,702
Kuota antarësimi në IEKA	623,878	669,827
Nën Totali	13,812,978	11,360,750
Të tjera shpenzime Dega Kosovë	1,346,585	-
Totali	15,159,563	11,360,750

21. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Shpenzime udhëtimi dhe dieta	3,412,477	2,277,931
Shpenzime për pritje	1,984,624	1,200,219
Shpenzime utilitare dhe mirëmbajtje	1,591,907	1,423,297
Të ndryshme	1,368,565	1,230,097
Liçenca programesh kompjuterik	945,457	552,106
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	769,810	848,960
Trajnime dhe kualifikime dhe rekrutime	518,394	506,900
Prime sigurimi	469,895	378,494
Anëtarësime dhe abonime	273,034	291,730
Komisione bankare	270,031	253,072
Qera ambjenti	219,951	-
Promocione	122,210	231,259
Nën Totali	11,946,355	9,194,065
Të ndryshme Dega Kosovë	978,965	-
Totali	12,925,320	9,194,065

22. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Shpenzime për paga	94,552,524	84,660,149
Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	4,277,764	3,901,947
Shpërblime për raste të veçanta	50,000	50,000
Nën Totali	98,880,288	88,612,096
Shpenzime për personelin Dega Kosovë	5,499,989	
Totali	104,380,277	88,612,096

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2017 është 33 (2016: 29).

23. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjobat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Gjoba dhe penalitete	10,300	-
Provizion për zhvlerësim të të drejtave për arkëtim	(1,000,000)	3,000,000
Totali	(989,700)	3,000,000

24. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit dhe rezultatin nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërise. Ky zë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 detajohet si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Shpenzime për interesa	(9,777)	(1,767)
Humbje nga këmbimet valutore	(125,461)	(54,093)
Të ardhura nga këmbimet valutore	321,445	388,145
Totali	186,207	332,285

25. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
<i>Fitimi para tatimit</i>	15,530,301	7,961,633
<i>Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë)</i>	685,527	4,502,711
Shpenzime pritje dhe përcjellje	846,864	909,017
Penalitet, gjoha e dëmshpërblime	76,645	-
Provizion zhvlerësim kërkesa të arkëtueshme	(1,000,000)	3,000,000
Shpenzime të panjohura Kosove	185,438	
Shpenzime të tjera pa dokumenta të rregullt tatimore	576,580	593,694
<i>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</i>	<u>16,215,828</u>	<u>12,464,344</u>
	16,215,828	12,464,344
<i>Tatim fitimi 15%</i>	2,432,374	1,869,652
Fitimi i Vitit	<u><u>13,097,927</u></u>	<u><u>6,091,981</u></u>

26. Angazhime dhe pasiguri*Çeshtje gjyqesore*

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çeshtje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 dhjetor 2017 Shoqëria nuk ka asnjë çeshtje gjyqesore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

27. Ngjarje pas datës së bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.
